



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 0734 prot.

Tiranë, më 30.12.2024

UDHËZIM

Nr. 01 Datë 30.12.2024

**MBI RAPORTIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS
DHE MIRATIMIN E FORMULARIT TË RAPORTIMIT**

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të gërmës "b" të nenit 23, dhe të nenit 125, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar (në vijim "LPP"), pikës 6, 7 dhe 8, të nenit 107 dhe nenit 115 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar (në vijim "VKM"),

UDHËZON:

1. Komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, është struktura përgjegjëse e ngritur nga titullari i autoritetit/entit kontraktor, që ka detyrimin të ndjekë me përpikmëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës, në përputhje me kushtet e prokuruarra dhe me legjislacionin në fuqi.
2. Përveç detyrave për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës që janë përgjegjësi e komisionit, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë një person ose disa persona nga ky komision për realizimin e detyrës/ave të veçanta të parashikuara në gërmat "a - f" të pikës 6 të nenit 107, të VKM.
3. Në përfundim të zbatimit të një kontrate të lidhur pas një procedure me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlerë të vogël, personi/at përgjegjës të ngarkuar nga titullari për kryerjen e detyrave të sipërcituara, përgatit/sin formularin e raportimit për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, i cili pasi miratohet nga titullari, i përcillet APP-së.

Në formularin e raportimit përfshihet:

- a) informacioni mbi të dhënat e kontratës si: Nr. Prot., datë, datën e lidhjes së kontratës, datën e hyrjes në fuqi (datën e fillimit të punimeve për kontratat e punëve publike), kohëzgjatjen, vlerën, sigurimin e kontratës, nëse ka fond rezervë, nëse është kontratë

në bazë të një marrëveshje kuadër, numrin e referencës së procedurës/lotit të përfunduar me nënshkrimin e kësaj kontrate, tipin e kontratës, kontraktori/ët, nënkontraktori, mbikëqyrësi dhe kolaudatori për kontratat e punëve;

- b) informacioni mbi ecurinë e zbatimit të kontratës të tilla si, situatat konkrete të evidentuara gjatë zbatimit, sipas rastit, të tilla si modifikimet e kontratës, ndërprerja, përfundimi apo shpallja e pavlefshme e kontratës, si dhe arsyet, rrethanat dhe argumentimi përkatës, mbi bazën e dispozitave ligjore që është bërë modifikimi, ndërprerja, përfundimi, apo shpallja e pavlefshme e kontratës;
- c) informacioni mbi të gjitha situatat apo problematikat e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti;
- ç) informacioni nëse kontrata është zbatuar me korrektësi dhe cilësi;
- d) informacioni në lidhje me shlyerjen e plotë të detyrimit financiar, si dhe nëse likuidimi i pagesave është kryer sipas parashikimeve në kontratë.

Një kopje e këtij formular raportimi për zbatimin e kontratës i dërgohet APP-së, jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit ose zgjidhjes së kontratës.

- 4. Formulari i raportimit për zbatimin e kontratës, bëhet sipas formularit standard për raportimin e zbatimit të kontratës, pjesë e këtij udhëzimi.

Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2, datë 18.03.2022, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

